



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:091406

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05830846

C.nr.576/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Berat Spahiu, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.S nga fshati ..., Komuna e Vitisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Burim Islami, avokat në Zyrën e Avokatisë B&B, Sh.p.k, me adresë në Rr.”...””,kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “...”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimi i dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 5,517.50€, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor e publik, më datë 10.06.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.S nga fshati ..., Komuna e Vitisë dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimit “...”, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial nga baza e autopërgjegjësishë, që ka pësuar paditësi nga lëndimet e marra nga aksidenti i trafikut të datës 10.02.2021, në rrugën magjistrale Ferizaj - Gjilan, në fshatin Partesh, t’ia paguaj shumat e specifikuara, edhe atë:

A. Në emër të kompensimit të dëmit material, t’ia paguaj shumat e specifikuara si më poshtë:

- Në emër të shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 217.50 euro;
- Në emër të ndihmës nga personat e tretë, shumën prej 200.00 euro;
- Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 200.00 euro;
- Në emër të rehabilitimit fizik, shumën prej 100.00 euro;

DETYROHET e paditura që paditësit të gjitha shumat e gjykuara në emër të dëmit material, t’ia paguaj shumën prej 717.50 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 14.05.2021 si datë e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive.

B. Në emër të kompensimit të dëmit jo material, t’ia paguaj shumat e specifikuara si më poshtë:

- Në emër të dhimbjeve fizike të të gjitha intensiteteve, shumën prej 2,500.00 euro;
- Në emër të frikës të të gjitha të gjitha intensiteteve shumën prej 1,500.00 euro;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 1.000.00 euro;

DETYROHET e paditura që paditësit të gjitha shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material, t'ia paguaj shumën prej 5,000.00 euro, me kamatë ligjore-vjetore prej 8%, duke filluar nga data 10.06.2024, si datë e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit M.S nga fshati ..., Komuna e Vitisë, përtej shumave të gjykuara si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi, edhe atë në emër të dëmit material, shuma prej 300.00 euro, kurse në emër të dëmit jomaterial, shuma prej 4,800.00 euro.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimi "Siguria", me seli në Prishtinë, që paditësit M.S, t'ia paguaj shpenzimet procedurale, dhe atë në lartësi të përgjithshme prej 909.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm ligjor. Pjesën tjetër të kërkesave në lartësi prej 499.00€ të kërkuar përtej shumës së gjykuar, gjykata e ka refuzuar si të pabazuar me TOAK-së.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, avokatit Burim Islami, në thëniet e tij të paraqitura si në padi, shqyrtimet gjyqësore dhe fjalën përfundimtare, ka theksuar se më datë 10.02.2021, në Rrugën e Ferizajit, në fshatin Partesh, është shkaktuar aksident komunikacioni dhe se deri tek aksidenti ka ardhur atëherë kur makina "A", duke lëvizur në rrugën Ferizaj-Gjilan në drejtim të fshatit Partesh, duke mos mbajtur skajin e djathtë të rrugës, godet në pjesën e përparme në anën e majtë automjetin "B" i cili po lëvizte në drejtim të kundërt të lëvizjes, me ç'rast humb drejtimin dhe godet rrethojën e oborrit, e që përveç dëmeve materiale, lëndime ka pësuar M.S, për çka paditësi si pasojë e lëndimeve të marra është dërguar në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan, më ç'rast i është dhënë ndihma e nevojshme mjekësore, ndihmë kjo e cila ka vazhduar edhe më tej përmes vizitave mjekësore të realizuara tek mjeku ortoped-traumatolog si dhe për shkak të përjetimit të frikës së lartë, i njëjti ka marrë edhe tretman psikiatrik. Tutje, i autorizuari i paditësit, kësaj gjykate i bën të ditur faktin se i janë drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e dëmit të pësuar në aksidentin e lartëcekur, mirëpo e paditura nuk ka treguar rezultat në këtë drejtim, duke ofruar kështu oferta të cilat ishin të pakënaqshme për paditësin, ashtu që, në pamundësi të gjetjes së ndonjë alternative tjetër të procedurës jashtëgjyqësore, paditësi i është drejtuar gjykatës me padi.

Andaj bazuar nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tersi si të bazuar dhe të detyroj të paditurën që në emër të dëmit material dhe jomaterial për shkak të lëndimeve trupore të pësuar me rastin e aksidentit të datës 10.02.2021, e njëjta t'i paguaj paditësit si në vijim: Në emër të kompensimit të dëmit material, t'ia paguaj shumat e specifikuar si më poshtë: Në emër të shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 217.50 euro; Në emër të ndihmës nga personat e tretë, shumën prej 300.00 euro;

Gjithsejt në emër të dëmit material shumën prej 1,017.50 euro me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 10.06.2024 e deri në pagesën definitive.

Në emër të kompensimit të dëmit jo material, t'ia paguaj shumat e specifikuara si më poshtë: Në emër të dhimbjeve fizike të të gjitha intensiteteve, shumën prej 4,000.00 euro; Në emër të frikës të të gjitha intenziteteve, shumën prej 2,800.00 euro; Në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 3,000.00 euro; Gjithsejt në emër të dëmit material shumën prej 9,800.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 14.05.2021 si datë e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar edhe atë; në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 104.00 euro; në emër të taksës gjyqësore, shumën prej 100.00 euro; në emër të përfaqësimit për tri seanca gjyqësore të mbajtura me nga 270.00 euro, për seancë, në emër të ekspertizës ortopedisë, shumën prej 150.00 euro; në emër të ekspertizës së psikiatrisë, shumën prej 150.00 euro; apo në shumë të përgjithshme prej 1,408.00 euro.

I autorizuari i të paditurës në përgjigje në padi, ka deklaruar se për të paditurën nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por kontestuese është lartësia e saj.

Gjykata në seancën gjyqësore të datës 10.06.2024, ka konstatuar se pala e paditur mungon dhe mungesën e njejta nuk e ka arsytuar, pasi që kërkesës për shtyerje nuk i ka bashkangjitur asnjë provë materiale, ashtu që, me pëlqimin e palës paditëse që seanca gjyqësore të vazhdojë pa praninë e të paditurës, ka mbajtur seancën gjyqësore në të cilën ka administruar provat dhe ka vlerësuar pretendimet e palës paditëse.

Provat e propozuara.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, ka administruar provat materiale dhe atë: Raporti i aksidentit me shifrën 2021-CR-080, i datës 10.02.2021, së bashku me skicën e vendit; Raporti nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, në emër të M.S, me nr. prot. 2674, i datës 10.02.2021; Raporti i Përgjithshëm mjekësor, i lëshuar nga Poliklinika “...” në Gjilan, në emër të M.S; Raporti nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, me nr.prot 88, i datës 10.02.2021; Konstatimi i mjekut radiolog, i datës 12.02.2021 lidhur me leximin e MRI-së, ku janë dhënë edhe konstatimet; Raporti specialistik i lëshuar nga dr. XH.G- specialist i ortopedisë, i datës 11.02.2021; Raporti specialistik, i lëshuar nga Spitali Kirurgjik “...” në Prishtinë, i datës 15.02.2021; Raporti Specialistik, i lëshuar nga Poliklinika “...”, i datës 27.02.2021; Kuponët fiskal lidhur me shpenzimet e mjekimit dhe pagesa e këtyre shpenzimeve; Kërkesa për kompensimin e dëmit drejtuar të paditurës nga ana e paditësit, e datës 18.03.2021; Ankesa e ushtruar ndaj vendimit të kompanisë mbi trajtimin e kërkesës për kompensimin e dëmit sipas shifrës 331A/21, e datës 08.04.2021; Njoftimi për trajtimin e dëmit 331A/21, i datës 08.04.2021, lëshuar nga ana e të paditurës K.S “Siguria”; Ekspertiza psikiatrike e datës 15.03.2024, e punuar nga eksperti i licencuar gjyqësor, dr. A.C; Ekspertiza oriopedike/traumatologjike e datës 11.03.2024, e punuar nga eksperti i licencuar gjyqësor, dr. A.L

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të lartcekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në këtë çështje kontestimore nuk ka qenë kontestues baza juridike e padisë, por në mes të palëve kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadisë.

Nga Raporti i aksidentit me shifrën 2021-CR-080, i datës 10.02.2021, së bashku me skicën e vendit, gjykata ka vërtetuar faktin se se më datë 10.02.2021, në rrugën magjistrale Ferizaj - Gjilan në fshatin Partesh, është shkaktuar aksident komunikacioni dhe se deri tek aksidenti ka ardhur atëherë kur makina “A”, duke lëvizur në rrugën Ferizaj-Gjilan në drejtim të fshatit Partesh, duke mos mbajtur skajin e djathtë të rrugës, godet në pjesën e përparme në anën e majtë automjetin “B” i cili po lëvizte në drejtim të kundërt të lëvizjes, me ç’rast humb drejtimin dhe godet rrethojën e oborrit, e që përveç dëmeve materiale, e po ashtu, lëndime trupore ka pësuar M.S, fakt që konfirmohet nga përmbajtja e të dhënave në Raportin nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan r i datës 10.02.2021, në emër të M.S, me nr. prot. 2674 dhe raportet tjera të trajtimit mjekësor siq janë; Raporti i Përgjithshëm mjekësor, i lëshuar nga Poliklinika “...” në Gjilan, në emër të M.S; Raporti nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, me nr.prot 88, i datës 10.02.2021; Konstatimi i mjekut radiolog, i datës 12.02.2021 lidhur me leximin e MRI-së, ku janë dhënë edhe konstatimet; Raporti specialistik i lëshuar nga dr. XH.G-specialist i ortopedisë, i datës 11.02.2021; Raporti specialistik, i lëshuar nga Spitali Kirurgjik “Aloka” në Prishtinë, i datës 15.02.2021; Raporti Specialistik, i lëshuar nga Poliklinika “...”, i datës 27.02.2021; Nga Konstatimi i mjekut radiolog, i datës 12.02.2021 lidhur me leximin e MRI-së, ku janë dhënë edhe konstatimet, gjykata ka vërtetuar faktin se ekzaminimi është bërë në prerje prej 1 mm dhe rekonstrukcione për rrafshin sagjital, koronaurë si dhe në dritaren kockore, për çka është gjetur se trupat e unazave janë me lartësi normale, në indet e buta të pjesës së pasme të qafës, prapa proceseve spinoze të C-6 dhe C-7 vërehet fragment i lirë kockor, me madhësi 1 cm që nuk ndërlihet me traumën aktuale, e që sipas të gjitha gjasave, lidhet me ndonjë traumë të mëhershme ose kalcifikat, me çka me lokalizim median dhe mbrapa pr.spinoze të C6-C7, vërehet prani e fragmentit kockor me diametër rreth 5x5 mm, pa prani të BMEP- ndryshimeve subchondrale, post-traumatike, pa prani të ndryshimeve inflamatore në indet e buta përreth, nuk vërehen shenja për HD/komprimim foraminal, nuk vërehen shenja për lesione intramedullare dhe lesione traumatike.

Po ashtu, gjykata konstaton se paditësi me kërkesë për kompensimin e dëmit e datës 18.03.2021, ju drejtuar të paditurës, e po ashtu, ndaj vendimit të paditurës, paditësi ka ushtruar ankesë, por nuk ka pasur sukses, pasi që nga njoftimi për trajtimin e dëmit 331A/21, i datës 08.04.2021, lëshuar nga ana e të paditurës K.S “Siguria, Komisioni për trajtimin e dëmeve K.S “Siguria”, ka shqyrtuar kërkesën e paditësit për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial dhe ka bërë ofertë për kompensimin e dëmit, (referuar edhe dëmit material edhe atij jomaterial), në shumën prej 522.50 euro.

Meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse kontestuese ishte lartësia e dëmit, gjykata ka caktuar ekspertizë psikatrike e datës 15.03.2024, të cilën e ka punuar eksperti i licencuar gjyqësor, dr. A.C, ku eksperti, pas ekzaminimit të paditësit, ka konstatuar se i njejt i ka pësuar frikë primare të intensitetit të lartë, që në rastin konkret ka zgjatur një minutë, frikë kjo që konsiderohet që

përjetohet si emocion gjatë shfaqjes (manifestimit) të fatkeqësisë në trafik, apo lëndimet në vendin e punës, por edhe pas momentit të lëndimit të pësuar sikur edhe pas fatkeqësisë, dhe kështu ajo interpretohet si një përgjigje afektive ndaj rrezikut direkt. Ndërsa, lidhur me frikën sekondare, e cila manifestohet më pastaj, pra është ngushtë e lidhur me periudhën e rikuperimit të plotë fizik por edhe psikik nga lëndimet e fituara, e që, në rastin konkret kjo frikë ka qenë e pranishme për 3 javë. Tutje, në raport thuhet se karakteristikë e frikës sekondare është po ashtu edhe mundësia që ajo të ketë ndikim direkt në prishjen apo dëmtimin e baraspeshës psikike gjatë periudhës kohore që përfshin rikuperimin e plotë.

Nga Ekspertiza Ortopedike/traumatologjike e datës 11.03.2024, e punuar nga eksperti i licencuar gjyqësor, dr. A.L, gjykata ka vërtetuar faktin se dëmtimet që i janë shkaktuar paditësit, kanë qenë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, të furishëm dhe të rëndë mbretës (jo i mprehtë), dhe si të tilla së bashku bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore. Në raport theksohet se në çastin e lëndimit, gjatë intervenimit mjekësor dhe terapisë mjekësore si dhe gjatë periudhës së përmirësimit, i dëmtuari ka patur dhimbje të intensitetit posaçërisht të lartë që ka zgjatur 15 min (mendohet koha që kalon pacienti nga vendi i aksidentit deri në institucionin shëndetësor), dhimbje të intensitetit të lartë që ka zgjatur 1 orë (që konsiston në kohën që ka kaluar gjatë marrjes së terapisë dhe ekzaminimeve të bëra), dhimbjes me intensitet të mesëm që ka zgjatur 10 ditë (duke iu referuar kohës së marrjes së terapisë aktive për dhembje) si dhe dhimbjes së intensitetit të ulët që ka zgjatur 21 ditë e që i referohet kohës sa edhe ka zgjatur trajtimi për këtë lloj të lëndimit. Të dëmtuarit (këtu paditësit M.S) i është nevojitur ndihma dhe kujdesi i personit tjetër për periudhën kohore prej 2 javësh (koha në të cilën pacienti ka patur kontrolla mjekësore specialistike), ushqimit të përforcuar, e cila ka zgjatur 2 javë (e cila përfshin ushqimin e padur me vitamina e minerale që të forcohen forcat e brendshme imunitare me qëllim të rehabilitimit sa më të shpejtë), shërimit klimatik-fizioterapeutik që ka zgjatur 10 ditë (ashtu që, pas çdo lëndimi të tillë është i indikuar trajtimi fizikal që lëvizjet në qafë të kthehen në pozitë normale), me çka konkludojmë se kemi të bëjmë me lëndime të rënda trupore të cilat pas rehabilitimit janë të shërueshme.

Baza ligjore

Me dispozitën e nenit 136 parag.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) është paraparë se *“kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, po ashtu, me nenin 137 të këtij ligji përkufizohet se çka përfshin dëmi *“dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*, po ashtu me nenin 140 parashihet se *“fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Me dispozitat e neit 169 dhe 172 të LMD-së është paraparë saktë se *„në rast dëmtimi duhet të bëhet kompensimi i dëmit dhe të bëhet rikthimi në gjendje të mëparshme, e nëse kjo nuk është e mundur të bëhet kompensimi në të holla. Me dispozitën e nenit 179 të LMD-së është parashikuar se „kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të ia shpërblej shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit. Në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të mëtejshëm janë zhdukur ose janë pakësuar, personi*

përgjegjës ka për detyrë t'i paguajnë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm. Sipas dispozitës së nenit 183 par.1 dhe 2 të po këtij ligji është parashikuar se për dhembjet e shkaktuara fizike, shpirtërore, për zvogëlim të aktivitetit jetësor, shëmtimit, cenimit të autoritetit, nderit, lirive ose të drejtave të personalitetit, vdekjes së personit të afërm si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit e sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla pavarësisht nga dëmi material. Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material si dhe për rëndësinë e saj, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të mirës dhe qëllimit që i shërben ky shpërblim.

Gjykata, me rastin e vendosjes duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, si dispozita materiale ka aplikuar nenet: 136.parag.1, 137, 140, 159 parag.1, 169. 172,179 183 parag.1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD), si dhe dispozitën e nenit 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Me nenin 136 parag.1 të LMD-së, është paraparë se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, po ashtu me nenin 137 të këtij ligji, është paraparë se “ Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”. Po ashtu, me nenin 140 parashihet se “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”, kurse sipas nenit 159 parag.1, parashihet se “Në rast aksidenti nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”. Po ashtu, me nenin 169 dhe 172 të po këtij ligji, është paraparë saktë se në rast dëmtimi duhet të bëhet kompensimi i dëmit dhe të bëhet rikthimi në gjendje të mëparshme, e nëse kjo nuk është e mundur të bëhet kompensimi në të holla. Tutje, me nenin 179 të ligjit, është parashikuar se kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të ia shpërblej shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit. Në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të mëtejshëm janë zhdukur ose janë pakësuar, personi përgjegjës ka për detyrë t'i paguajnë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm. Sipas nenit 183 par.1 dhe 2 të po këtij ligji, është parashikuar se për dhembjet e shkaktuara fizike, shpirtërore, për zvogëlim të aktivitetit jetësor, shëmtimit, cenimit të autoritetit, nderit, lirive ose të drejtave të personalitetit, vdekjes së personit të afërm si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit e sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla pavarësisht nga dëmi material. Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material si dhe për rëndësinë e saj, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të mirës dhe qëllimit që i shërben ky shpërblim. Me nenin 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, është parashikuar se personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditësit, pasi gjeti se paditësi ka vërtetuar se me aksidentin e shkaktuar më datë 15.05.2020, përgjegjësia bie mbi të siguarin rrespektivisht suguruesin, me ç'rast të njëjtit i ka lindur e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ky aksident. Gjykata pas vlerësimit të provave të lartcekura, si dhe thënieve palës paditëse të parashtruara në padi dhe gjatë seancave të mbajtura, vlerëson se në rastin konkret në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se më datën 10.02.2021 ka ndodhur një aksident trafiku, ku nga ky aksident kanë pësuar lëndime paditësi. Po ashtu gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse baza juridike e kërkesëpadisë, mirëpo kontestuese në mes të palëve në këtë kontest ishte lartësia e kërkesëpadisë.

Deri te ky konstatim, gjykata erdhi duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë dhe dispozitat ligjore në fuqi, edhe atë se shkaktuesi i dëmit kompenzon të dëmtuarin (neni 136 i LMD-së); se shkaktuesi i dëmit përgjigjet sipas fajësisë dhe kontributit (neni 140 dhe 176 i LMD-së); se për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, rrespektivisht siguruesi, nëse zotëruesi e ka siguruar sendin (neni 155, 159 dhe 960 i LMD-së); dhe se në rast shkaktimi të dëmit material (ndihma dhe kujdesi i huaj, ushqimi i përforcuar dhe shpenzimet e shërbimeve mjekësore) dhe dëmi jomaterial (dhembje fizike dhe frikë) shpërblehet në të holla ky dëm i shkaktuar (neni 172 dhe 179 i LMD-së).

Gjykata ia fali në tërësi besimin ekspertizave të administruara në këtë çështje kontestimore, edhe atë ekspertizën mjekësore ortopedike dhe ekspertizës psikiatrike, pasi gjeti se të njëjtat janë punuar nga specialist të fushës përkatëse, janë punuar në mënyrë profesionale dhe i janë përgjigjur çështjeve të parashtruara nga të njëjtit, duke përdorur metodat e ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë (ekspertiza ortopedike dhe ekspertiza e psikiatrisë), ashtu që në bazë të ekspertizës psikiatrike, të datës 15.03.2024, e punuar nga eksperti i licencuar gjyqësor, dr. A.C, është vërtetuar fakti se paditësi ka pësuar frikë primare të intensitetit të lartë, që në rastin konkret ka zgjatur një minutë, frikë kjo që konsiderohet që përjetohet si emocion gjatë shfaqjes (manifestimit) të fatkeqësisë në trafik, si dhe frikë sekondare, e cila manifestohet më pastaj, pra është ngushtë e lidhur me periudhën e rikuperimit të plotë fizik por edhe psikik nga lëndimet e fituara, e që, në rastin konkret kjo frikë ka qenë e pranishme për 3 javë. Tutje, në raport thuhet se karakteristikë e frikës sekondare është poashtu edhe mundësia që ajo të ketë ndikim direkt në prishjen apo dëmtimin e baraspeshës psikike gjatë periudhës kohore që përfshin rikuperimin e plotë. Lëndimet trupore të paditësit janë dëshmuar edhe nga ekspertiza ortopedike/traumatologjike e datës 11.03.2024, përmes së cilës theksohet se dëmtimet që i janë shkaktuar paditësit, kanë qenë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, të furishëm dhe të rëndë mbretës (jo i mprehtë), dhe si të tilla së bashku bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore, ashtu që në çastin e lëndimit, gjatë intervenimit mjekësor dhe terapisë mjekësore si dhe gjatë periudhës së përmirësimit, i dëmtuari ka patur dhimbje të intensitetit posaçërisht të lartë që ka zgjatur 15 min (mendohet koha që kalon pacienti nga vendi i aksidentit deri në institucionin shëndetësor), dhimbje të intensitetit të lartë që ka zgjatur 1 orë (që konsiston në kohën që ka kaluar gjatë marrjes së terapisë dhe ekzaminimeve të bëra), dhimbjes me intensitet të mesëm që ka zgjatur 10 ditë (duke iu referuar kohës së marrjes së terapisë aktive për dhembje) si dhe dhimbjes së intensitetit të ulët që ka zgjatur 21 ditë e që i referohet kohës sa edhe ka zgjatur trajtimi për këtë lloj të lëndimit. Të dëmtuarit (këtu paditësit M.S) i është nevojitur ndihma dhe kujdesi i personit tjetër për

periudhën kohore prej 2 javësh (koha në të cilën pacienti ka patur kontrolla mjekësore specialistike), ushqimit të përforcuar, e cila ka zgjatur 2 javë (e cila përfshin ushqimin e padur me vitamina e minerale që të forcohen forcat e brendshme imunitare me qëllim të rehabilitimit sa më të shpejtë), shërimit klimatik-fizioterapeutik që ka zgjatur 10 ditë (ashtu që, pas çdo lëndimi të tillë është i indikuar trajtimi fizikal që lëvizjet në qafë të kthehen në pozitë normale), me çka konkludojmë se kemi të bëjmë me lëndime të rënda trupore të cilat pas rehabilitimit janë të shërueshme.

Gjykata sa i përket natyrës së lëndimeve, shkallën dhe intensitetit të dhembjeve fizike, frikës së përjetuar, konstatoi se paditësi ka pësuar lëndime trupore të rënda të shoqëruara me dhembje fizike e frikë të intensitetit duke filluar nga ai posaçërisht i rëndë e deri te intensiteti i ulët.

Sa i përket ndihmës dhe kujdesit nga personi i huaj dhe nevojës për ushqim të përforcuar, gjykata konstatoi se paditësit i janë nevojitur 14 ditë perkujdesje dhe ndihmë nga personi i tretë, 14 ditë ushqim i përforcuar si dhe 10 ditë rehabilitim fiziatrik.

Gjykata vlerën e shumave të theksuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi e mori duke u bazuar në Udhëzuesin për Caktimin e Kriteve Orientuese dhe Lartësisë së Shpërblimit të Drejtë në të Holla të Dëmit Jomaterial të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me nr.41/2023, të datës 27.02.2023 dhe dispozitata ligjore nga Ligji për Mardhëniet e Detyrimeve.

Nga të gjitha të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi vlerësoi se shumat e kërkuara nga paditësi pasqyrojnë një shumë që i përgjigjet realisht këtyre dhembjeve, tërë kjo duke u mbështetur në praktikat e deritanishme. Gjykata ka parasysh se me shkaktimin e dëmit të paditësi, asnjë shumë nuk do të rivendos gjendjen e mëparshme të dhembjeve të përjetuara nga ana e tij, mirëpo njëkohësisht gjykata është e thirrur të gjejë një shumë që nuk do të tejkalonte qëllimin për çka kompensohet kjo shumë, ashtu që qëllimi i këtij kompensimi nuk konsiston në pasurim të të dëmtuarit, por që të arrijë një satisfaksion, në atë masë që paditësi të bëjë ekuilibrimin e gjendjes së tij shpirtërore dhe për aq sa mundet sanimin e të mirës së cënuar. Këto shuma të gjykuara janë në përputhje të plotë me natyrën e të mirës së cënuar dhe qëllimit shoqëror për kompensimin e dëmit jomaterial, duke u bazuar edhe sipas mendimeve të ekspertëve mjekësor ortoped dhe psikiatër.

Përfundimisht, gjykata konsideron se lartësia e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të shpërblimit të dëmit material dhe jomaterial për paditësin është shpërblim real dhe objektiv dhe paraqet një formë të satisfaksionit që paditësi me këto mjete të shpërblehet për shpenzimet e krijuara me rastin e ndihmës dhe kujdesit nga personi i tretë dhe ushqimit të përforcuar, si dhe të shpërblehet për dhembjet fizike e shpirtërore të përjetuara me rastin e aksidentit. Me rastin e vendosjes për lartësinë e kërkesëpadisë për të gjitha kategoritë e caktuara të dëmit material dhe jomaterial ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben kompensimi i gjykuar me bindje se kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarin, në këtë rast paditësin.

Sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi si të pa bazuara. Mbi bazën e të lartëcekurave, gjykata vlerëson se shumat e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara nuk janë reale dhe nuk i përgjigjen shkallës së dëmit të shkaktuar paditësit.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, si në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë, e kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, kurse sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës të cilat i ka aprovuar palës paditëse, gjykata është bazuar në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, duke ia njohur kërkesën për shumën për përpilimin e padisë prej 104.00 euro; në emër të taksës gjyqësore, shumën prej 100.00 euro; në emër të përfaqësimit për tri seanca gjyqësore të mbajtura me nga 135.00 euro, për seancë, duke u bazuar në vlerën reale të kontestit deri në 10,000.00€, në emër të ekspertizës ortopedisë, shumën prej 150.00 euro; në emër të ekspertizës së psikiatrisë, shumën prej 150.00 euro; apo në shumë të përgjithshme prej 909.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm ligjor. Pjesen tjetër të kërkesave në lartësi prej 499.00€ të kërkuar përtej shumes së gjykuar, gjykata e ka refuzuar si të pabazuar me TOAK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:091406, 10.06.2024

Gjyqtari,
Berat Spahiu

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.